



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

---



**KORNIZA AFATMESMEBUXHETORE**  
**2019-2021**  
**KOMUNA FERIZAJ**

**FERIZAJ**  
Qershor - 2018

## Përmbajtja

I. Hyrje

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2019-2021

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjes dhe Financimi i Jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2019-2021




## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 (KAB 2019-2021) është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e pëgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktura me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale.

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2019/01 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Pergjegjësitet (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2019-2021. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:





## II. Deklarata Afatmesme e Prioriteteve 2019-2021 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Ferizajt gjendet në pjesën jugore të Kosovës, Është njëra nga komunat më të mëdha të vendit çka do të thotë se llogaritet si komuna e tretë më e madhe në vend. Pozita gjeografike që ka, i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Ferizajt ka gjithësej 44 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të Vitit 2011, Komuna e Ferizajt ka 108610 banorë të organizuar në 18359 ekonomi familjare .

Nga viti 2000 deri në fund të muajit maj 2018 në komunën tonë janë të regjistruara 11813 biznese sipas llojeve të ndryshme. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Ferizajt , 9994 janë biznese individuale , 1386 janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 345 janë ortakëri e përgjithshme dhe 88 janë lloje tjera..

Administrata e Komunës së Ferizajt është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat dy janë të vendosura brenda qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 9 të tilla në fshatra .

Vizioni i Komunës së Ferizajt i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siq janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2019/01 të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Ferizajt është i bazuar në strategjinë zhvillimore e cila bazohet në disa prioritete e që janë : Ekonomi të qëndrueshme lokale , politika afatgjate zhvillimore, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillim të agrobiznesit dhe zhvillim të kapaciteteve grumbulluese e përpunuese të produkteve bujqesore e blektorale, urbanizëm modern, shërbime efikase e kualitative publike e administrative, arsim cilësor-me tendencë të qartë e të vendosur të rritjes së rezultateve mësimore, rritjes së sigurisë në shkollë, dhe promovimit të kapaciteteve të shkollave profesionale si parakusht esencial i përgaditjes së kualifikuar të brezave të rinj për vende pune. Në tri vjetët e ardhshëm, Komuna e Ferizajt, synohet të rrisë intenzitetin e integritimit në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, më qëllim të absorbimit të fondeve zhvillimore dhe marrjen e përvojave për avancim të shërbimeve publike.. Pastaj, në periudhën e planifikuar afatmesme, Komuna e Ferizajt synon realizimin e projekteve kulturore, deri në arritje cilësore të një niveli të një qendre jo vetëm kombëtare, por e dhe rajonale kulturore.

Objektiv afatmesëm i Komunës, do të jetë edhe investimi programor e infrastrukturor, me qëllim të ngritjes cilësore të shërbimeve shëndetësore.

Po ashtu, projektet e infrastrukturës mbi e nëntokësore, synohet të jenë të tipit strategjik, të afta për të absorbuar rritjen intenzive të popullatës dhe veprimtarive ekonomike.



*Komuna jone bazohet ne pesë shtylla e qe jane bazament i zhvillimit ekonomik dhe social:*

**1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimin të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim i infrastrukturës arsimore, bursa për studime, laboratore), *përrurim i domosdoshmërisë së ngritjes së kapaciteteve të shkollave profesionale;*
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë.
- Mbështetjes së bizneseve – dhënia e tokave në shfrytëzim për veprimtari prodhuese e përpunuese, politika fiskale-tarifore e tatimore mbështetëse, subvencione etj..

**2. Përmirësimi i shëndetit publik dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Mbështetje familjeve me asistencë sociale , pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë-ofrimi i ambienteve të reja për aktivitete sportive e kulturore
- Mbështetje cilësore administrative e materiale kategorive të veçanta në nevojë

**3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimin dhe rigjenerimin të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi); transportit, kanalizimit, furnizimit me ujë, pastrimit, dezinfektimit e dezinfektimit
- Përmirësimin të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Vendosja e rregullit urban
- Investimet në përshtatjen e infrastrukturës tursitke në komunë, si garancë edhe e zhvillimit ekonomik të saj .

**4. Shërbime administrative e publike efikase e cilësore**

Përmirësimi i shërbimeve administrative e publike-komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë. Synohet të arrihet nëpërmjet:

- Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të lehtësimin të shërbimeve
- Digjitalizimit të mëtutjeshëm i avancuar i procedurave administrative dhe kualifikimit të mëtutjeshëm të personelit të komunës dhe shërbimeve tjera komunale, me qëllim të rritjes së efikasitetit në trajtimin e kërkesave dhe pritjeve të qytetarëve
- sistem efikas i kanalizimit
- Rritje e nivelit të furnizimit me ujë dhe zvogëllim i humbjeve teknike të ujit
- Menaxhim më efikas i projekteve për rritje të sigurisë në komunikacion
- Projekte dhe investime cilësore në zvogëllimin e dëmeve eventuale nga fatkeqësitë elementare

**5. Arsimit cilësor, fuqizim i bazës teknike, programore dhe profesioniste**

Nëpërmjet përshtatjes së politikave të avancuara, synohet:

- Fuqizim i shkollave profesionale, me qëllim të përgatitjes silësore të kuadrove për tregun e punës



-investime në ngritje të shkollave të reja dhe renovime të objekteve të degraduara shkollore  
-Rritje e sigurisë dhe kontrollë e shtuar e shëndetit të nxënësve në shkolla  
-Zvogëlim i numrit të nxënësve në paralele, me qëllim të rritjes së rezultateve mësimore  
-Rritje e investimeve në laboratore shkencore e punëtori dixhitale në shkolla  
-Rritje e bashkëpunimit të shkollave të komunës, me shkolla jashtë vendit, me qëllim të këmbimit të përvojave cilësore

Respektim i procedurave në përzgjedhjen e stafit cilësor mësimor në shkolla

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2019-2021 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon (shih tabelën më poshtë). Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 e aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe domografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, 2019 - 2021 .

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Qeveria e komunës së Ferizajt, planifikon të bëjë uljen e tatimit në pronë për 10%, të bazës tatimore, në momentin e miratimit të rregullores së tatimit në pronë për vitin fiskal 2019 mbështetur në platformën qeverisëse 2017-2021. Kjo ulje e bazës tatimore për kuotën 10%, sipas analizave buxhetore e financiare, nuk do të ndikojë negativisht në planin e parashikuar të të hyrave vetanake për vitin 2019, pasi që komuna tashmë i ka të evidentuara në sistemin e saj llogarit e arkëtueshme të tatimit në pronë të cilat arrijnë vlerën financiare rreth 6 milion euro, pra qeveria komunale do të hartoj strategji të re rreth inkasimit të llogarive të akëtueshme, në mënyrë që ndikimi i uljes së bazës tatimore fare mos të vërehet. Në anën tjetër, ulja e bazës tatimore, do të ketë inpakt pozitiv për bizneset tona, si dhe mirëqenien qytetare pasi që do të mundëson rritjen e vlerës financiare në qarkullim dhe në të njejtën kohë rritjen e të ardhurave.

Burimet e financimit komunal janë:

1. Grantet Qeveritare;
2. Të Hyrat Vetanake; dhe
3. Huamarrja sipas qarkores buxhetore 2019/01 Fondet e ndara nga huamarrja në MASHT në nënprogramet „Administrata qendrore dhe Investimet kapitale në Arsimin Parauniversitar” në kuader të projektit „Reforma në arsim” Komuna jone po ashtu eshte pranuese e granteve të donatorëve (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe ka mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi



### 3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afat-mesëm 2019-2021

Të hyrat e Komunës së Ferizajt nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

*Tabela e të hyrave komunale sipas burimit të financimit*

| Përshkrimi                      | Buxheti aktual për vitin 2018 | Kufijt e financimit qarkorja 2019/01 | 2020 Vlerësimi       | 2021 Vlerësimi       |
|---------------------------------|-------------------------------|--------------------------------------|----------------------|----------------------|
| <b>TË HYRAT KOMUNALE TOTALE</b> | <b>29,248,881.00</b>          | <b>30,934,845.00</b>                 | <b>31,949,122.00</b> | <b>33,048,498.00</b> |
| Grantet qeveritare              | 24,514,191.00                 | 25,544,003.00                        | 26,509,951.00        | 27,433,355.00        |
| Të hyrat vetanake               | 4,553,220.00                  | 5,103,198.00                         | 5,279,171.00         | 5,455,143.00         |
| Grant shtesë Sh.R.              | 165,000.00                    | 160,000.00                           | 160,000.00           | 160,000.00           |
| Huamarrja                       | 16,470.00                     | 271,644.00                           |                      |                      |

Komuna e Ferizajt, financohet nga transferet qeveritare të cilat në tre vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 84.43% (mesatarja për tri vitet) të buxhetit të përgjithshëm të komunës, dhe nga të hyrat vetanake me 15.57% Pjesmarrja në tri vitet e ardhshme është:

Viti 2019 grant qeveritar është 83.09% dhe të hyra vetanake komunale janë 16.91%

Viti 2020 granti qeveritar është 83.48% dhe të hyrat vetanake komunale janë 16.52%

Viti 2021 granti qeveritar është 83.50% dhe të hyrat vetanake komunale janë 16.50% .

Në bazë të dhënave të sipërme vërehet se granti qeveritar ka një rritje të ngadaltë nga viti në vit.

Transferet qeveritare sipas kufijëve fillestar të Komisionit të granteve, për vitin 2019 do të jetë në lartësi prej 25,544,003.00€ dhe me këtë pjesmarrje strukturale:

Granti i Përgjithshëm me 40.04% ;s

Granti Specifik për Arsim, me 47.35% ; dhe

Granti Specifik për Shëndetësi, me 12.61%;

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

| Të hyrat nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake të krahasuara në mes vitit aktual dhe qarkores buxhetore 2019/01 |                      |                                       |                              |                          |
|--|----------------------|---------------------------------------|------------------------------|--------------------------|
| Përshkrimi   | Viti 2018            | Të dhënat nga qarkorja e pare 2019/01 | Krahasimi 2019-2018 në vlerë | Krahasimi 2019/2018 në % |
|  | Buxheti aktual       |                                       |                              |                          |
| Granti i përgjithshëm  | 10,041,665.00        | 9,908,869.00                          | -132,796.00                  | 98.68%                   |
| Granti specifik i shëndetësisë   | 2,958,888.00         | 3,258,300.00                          | 299,412.00                   | 110.12%                  |
| Granti specifik i Arsimit  | 11,513,638.00        | 12,232,834.00                         | 719,196.00                   | 106.25%                  |
| Të hyrat vetanake  | 4,553,220.00         | 5,103,198.00                          | 549,978.00                   | 112.08%                  |
| Grant shtesë Sh.R.   | 165,000.00           | 160,000.00                            | -5,000.00                    | 96.97%                   |
| Huamarrja  | 16,470.00            | 271,644.00                            | 255,174.00                   | 1649.33%                 |
| <b>totali</b>  | <b>29,248,881.00</b> | <b>30,934,845.00</b>                  | <b>1,685,964.00</b>          | <b>105.76%</b>           |

Siq vërehet nga tabela kemi rritje të buxhetit për 5.76% në krahasim me vitin 2018 .

Në komunën tonë pjesa më e madhe e të hyrave vjen nga grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë.

Te hyrat e planifikuara nga tatimi në pronë për vitin 2019 janë 2,679,960.00€ ne përqindje 52.51% ne total te te hyrave vetanake, ndersa për vitin 2020 është 52.51% dhe vitin 2021 është 52.89% për arsye se nga fillimi i vitit 2019 do të grumbullohen të hyra nga tatimi i tokës. Përveç të hyrave nga Tatimi në Pronë, kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK si taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për matjet gjeodezike ne teren, taksa për lejet e ndërtimit, etj.

-Niveli i taksave dhe pagesave tjera eshte e rregulluar me rregulloret dhe udhëzime administrative te cilat jane ne fuqi.



TABELA e Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2021

|              | Përshkrimi                                    | Viti 2018 Plan       | Viti 2019 Plan       | Viti 2020 vlerësimi  | Viti 2021 vlerësimi  |
|--------------|---|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| <b>1</b>     | <b>TË HYRAT KOMUNALE-TOTALE</b>               | <b>29,248,881.00</b> | <b>30,934,845.00</b> | <b>31,949,122.00</b> | <b>33,048,498.00</b> |
|              | <b>GRANTI QEVERTAR</b>                        | <b>24,167,102.00</b> | <b>25,831,647.00</b> | <b>26,669,951.00</b> | <b>27,593,355.00</b> |
| <b>1.1</b>   | <b>TË HYRAT VETANAKE</b>                      | <b>4,553,220.00</b>  | <b>5,103,198.00</b>  | <b>5,279,171.00</b>  | <b>5,455,143.00</b>  |
| <b>1.1.1</b> | <b>Tatimi në pronë</b>                        | <b>1,977,949.00</b>  | <b>2,136,982.00</b>  | <b>2,136,982.00</b>  | <b>2,156,295.00</b>  |
| <b>1.1.2</b> | <b>Tatimi në tokë dhe mbledhja e borxheve</b> |                      | <b>542,978.00</b>    | <b>542,978.00</b>    | <b>542,978.00</b>    |
| <b>1.1.3</b> | <b>Taksat komunale</b>                        | <b>1,608,868.00</b>  | <b>1,508,868.00</b>  | <b>1,608,868.00</b>  | <b>1,665,000.00</b>  |
|              | Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve)        | 220,000.00           | 120,000.00           | 120,000.00           | 120,000.00           |
|              | Certifikatat dhe dokumentet zyrtare           | 100,000.00           | 100,000.00           | 100,000.00           | 110,000.00           |
|              | Taksat e pajisjeve motorike                   | 263,000.00           | 263,000.00           | 263,000.00           | 260,000.00           |
|              | Lejet për ndërtesa                            | 475,000.00           | 475,000.00           | 575,000.00           | 625,000.00           |
|              | Matjet gjeodezike                             | 250,868.00           | 250,868.00           | 250,868.00           | 250,000.00           |
|              | Taksat tjera komunale                         | 50,000.00            | 50,000.00            | 50,000.00            | 50,000.00            |
|              | Taksat per legalizimin e prones               | 250,000.00           | 250,000.00           | 250,000.00           | 250,000.00           |
| <b>1.1.3</b> | <b>Ngarkesat komunale</b>                     | <b>874,903.00</b>    | <b>822,870.00</b>    | <b>898,843.00</b>    | <b>1,000,870.00</b>  |
|              | Të hyrat nga qiraja                           | 150,000.00           | 150,000.00           | 150,000.00           | 200,000.00           |
|              | Bashkë-pagesat për arsim                      | 97,000.00            | 97,000.00            | 97,000.00            | 120,000.00           |
|              | Bashkë-pagesat për shëndetësi                 | 160,000.00           | 160,000.00           | 160,000.00           | 165,000.00           |
|              | Ngarkesat tjera komunale përfshir (gjobat)    | 467,903.00           | 415,870.00           | 491,843.00           | 515,870.00           |
| <b>1.1.4</b> | <b>Të hyrat tjera</b>                         | <b>91,500.00</b>     | <b>91,500.00</b>     | <b>91,500.00</b>     | <b>90,000.00</b>     |
| <b>1.2</b>   | <b>TRANSFERET QEVERTARE</b>                   | <b>24,695,661.00</b> | <b>25,831,647.00</b> | <b>26,669,951.00</b> | <b>27,593,355.00</b> |
| <b>1.2.1</b> | <b>Granti i përgjithshëm</b>                  | <b>10,041,665.00</b> | <b>9,908,869.00</b>  | <b>10,799,157.00</b> | <b>11,494,468.00</b> |
| <b>1.2.2</b> | <b>Granti specifik për arsim</b>              | <b>11,513,638.00</b> | <b>12,232,834.00</b> | <b>12,289,579.00</b> | <b>12,346,611.00</b> |
| <b>1.2.3</b> | <b>Granti specifik për shëndetësi</b>         | <b>2,958,888.00</b>  | <b>3,258,300.00</b>  | <b>3,421,215.00</b>  | <b>3,592,276.00</b>  |
| <b>1.2.4</b> | <b>Grantet dhe transferet tjera</b>           | <b>165,000.00</b>    | <b>160,000.00</b>    | <b>160,000.00</b>    | <b>160,000.00</b>    |
| <b>1.2.5</b> | <b>Haumarrja</b>                              | <b>16,470.00</b>     | <b>271,644.00</b>    |                      | -                    |



Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabela, dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2019-2021, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave direkte komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të investimeve kapitale, të cilat do të financohen nga ky burim i të hyrave.

## Huamarrja

- Fondet e ndara nga huamarrja në MASHT në nën-programet “Administrata qendrore dhe Investimet kapitale në Arsimin Parauniversitar”, në kuadër të projektit “Reforma në arsim” (Komponenta 1.3 e Ligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshje të huas), transferohen në komuna për vitin 2019 në shumë prej 526,960 euro. Transferet e tilla nuk janë subjekt i limitimeve të Grantit Specifik për Arsimin Parauniversitar. Komuna e Ferizajt sipas kësaj do të ketë financim nga huamarrja në arsim për vitin 2019 në vlerë prej 10,980.00€, (6,588.00€ për mallra dhe shërbime si dhe 4,392.00 për shpenzime kapitale). Shkollat do të vendosin për shpenzimin e mjeteve për projektet e parapara sipas “Planit Zhvillimor të Shkollës”. Këto projekte do të aprovohen nga MASHT-i paraprakisht. Shfrytëzimi i fondeve do të koncentrohet në përmirësimin e cilësisë në shkolla. Alokimi i fondeve për secilën komunë është bërë duke aplikuar formulën e paraparë me “Doracakun e Granteve për Zhvillimin e Shkollave”, që është nxjerrë nga MASHT.

- Fondet e ndara nga huamarrja në MSH-së janë transferuar në komuna në shumë prej 4,272,051€ për vitin 2019.

Shuma e alokuar për secilën komunë në baza vjetore do të jete subjekt i vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë për arritjen e kritereve të përcaktuara me Marrëveshjen e nënshkruar paraprakisht në mes të komunës dhe MSH-së.

Komuna e Ferizajt sipas kësaj do të ketë financim nga huamarrja në shëndetësi për vitin 2019 në vlerë prej 260,664.00€.

## 3. 4 Politikat e reja

Komuna Ferizajt në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale sic janë:

- Respektim të ligjit/ akteve nënligjore, respektimin e procedurave ligjore e administrative, përgjegjshmëri, llogaridhënie, përkushtim, profesionalizëm, efikasitet dhe efektivitet, transparencë në vendimarrje dhe procedura ekzekutive;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, efikasitet i lart në menaxhimin e financave publike, rritje e të hyrave, shpenzim efektiv dhe efikas i burimeve financiare;
- Subvencionimi i bizneseve me mjete monetare;
- Subvencionimi i kamatave kreditore për biznese;
- Themelimi i Qendres për Inovacion dhe Ndermarresi;
- Funksionalizimi i zonave ekonomike, krijimi i zonave të reja;
- Intensifikimi i aktiviteteve institucionale për joshjen e investimeve të huaja;
- Promovimi i potencialeve tona zhvillimore;



- Rritjen e transparencës buxhetore sidomos në aspektin e shpenzimeve;
- Hartimin e politikave në funksion të rritjes së të hyrave vetanake;
- Rritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore e sociale, sa me afër qytetarëve në nevojë; Synohet rritje e cilësisë së shëndetit dhe e mirëqenies së qytetarëve;
- Ngritje e cilësisë së mësimin, ngritje e cilësisë së kushteve për zhvillim të procesit mësimor, ngritje e kujdesit për personelin mësimor;
- Rritje e prodhimit, punësimit dhe të ardhurave familjare.
- Infrastrukturë fizike e teknike, mbi e nëntokësore e përshtatshme për të absorbuar kërkesat e rritura zhvillimore e jetike për një periudhë më të gjatë kohore

### 3.5 Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2019-2021, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Nisur nga katër (4) prioritetet tona strategjike për vitet 2019-2021, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si, të administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë e mirëqenies sociale.

Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2019-2021, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesëmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës prej 32.00 % në vitin 2019. Në sferën e realizimit të projekteve kapitale , rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike, si dhe realizimin e projekteve kapitale me koncesione dhe partneritet publiko-privat (PPP).


Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore komunale 2019/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2019, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje.

Si rezultat Komuna e Ferizajt prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

| Nr.   | Përshkrimi                                | Viti 2018<br>Buxheti aktual | Planifikimi për<br>Vitin 2019 | Viti 2020<br>Vlerësimi | Viti 2021<br>Vlerësimi |
|-------|---|-----------------------------|-------------------------------|------------------------|------------------------|
| 1     | <b>TË HYRAT<br/>KOMUNALE<br/>TOTALE</b>   | 29,249,881.00               | 30,934,845.00                 | 31,949,122.00          | 33,048,498.00          |
| 1.1   | Grantet qeveritare                        | 24,167,102.00               | 25,831,647.00                 | 26,669,951.00          | 27,593,355.00          |
| 1.2   | Të hyrat vetanake                         | 4,553,220.00                | 5,103,198.00                  | 5,279,171.00           | 5,455,143.00           |
| 1.3   | Huamarrja                                 | 16,470.00                   | 271,644.00                    |                        |                        |
|       | <b>SHPENZIMET<br/>KOMUNALE<br/>TOTALE</b> | 29,248,881.00               | 30,934,845.00                 | 31,949,122.00          | 33,048,498.00          |
| 2.1   | Shpenzimet rrjedhëse                      | 19,729,369.00               | 20,897,446.01                 | 20,896,122.42          | 21,008,869.50          |
| 2.1.1 | Pagat dhe mëditjet                        | 15,222,016.00               | 15,469,080.00                 | 15,549,400.41          | 15,662,147.42          |
| 2.1.2 | Mallrat dhe<br>Shërbimet                  | 3,454,921.00                | 4,369,994.00                  | 4,288,350.00           | 4,288,350.00           |
| 2.1.3 | Shpenzimet komunale                       | 452,680.00                  | 452,680.00                    | 452,680.00             | 452,680.00             |
| 2.1.4 | Subvencionet                              | 599,752.00                  | 605,692.00                    | 605,692.00             | 605,692.07             |
| 2.2   | Shpenzimet kapitale                       | 9,519,512.00                | 10,037,399.00                 | 11,052,999.58          | 12,039,628.51          |



Grafiku : Shpenzimet komunale në kategori ekonomike, për vitet 2019-2021



**-Pagat dhe Mëditjet** –Kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje është kategori ekonomike me pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimin e buxhetit me 50.00% e për vitin 2019, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të ketë një rritje të lehtë.

**-Mallrat dhe Shërbimet** –Pjesëmarrja e Kategorise se shpenzimeve për mallra dhe shërbime është 14.12%.Krahasuar me vitin 2018 kjo kategori ka rritje te pjesëmarrjes ne buxhetin e vitit 2019. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2018 është 12.00%

**-Shpenzimet komunale** – Kjo kategori nuk ka rritje të shpenzimeve në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018,pjesëmarrja e saj është 1.00% në buxhetin e vitit 2019, mirëpo kjo vlerë nuk është e mjaftueshme duke pasur parasysh se kemi zgjerimin e rrjeteve të ndriçimit publik, dhe ndertimi i objekteve që kanë të bëjnë me këto shpenzime. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2019 dhe vitet e të ardhshme nuk pritet te ketë ndryshime.

**-Subvencionet** –Në vitin 2019 kanë nje rritje te lehte, në krahasim me vitin 2018 Mirepo krahasuar me pjesëmarrjen ne buxhetin e vitit 2019 kane nje ulje te pjesëmarrjes me 1.95% kurse pjesëmarrja e tyre ne buxhetin e vitit 2018 është 2.05%.Programet të cilat kanë subvencione janë:

- Zyra e Kryetarit;
- Shëndetësi dhe Mireqenie sociale;
- Kulturë, rini, sport,
- Arsim dhe shkencë ;dhe
- Shërbime publike.

**Investimet Kapitale** - Kjo kategori e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2019, është pjesëmarrëse për 32.44%. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohen nga të hyrat vetanake të Komunës pothuajse 50.00% e te hyrave vetanake te Komunës orientohen për investime kapitale . Rritja në investimet kapitale, nga buxheti i Komunës do të përmirësohet nga viti në vit. Është kategoria e dytë për pjesëmarrje në shpenzimet e buxhetit.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2018, planifikimi për vitin e ardhshëm 2019 si dhe vlerësimet për vitet 2020 dhe 2021.



Shpenzimet Komunale 2018, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe (Viti aktual)

| Programet                    | Viti 2018   |                      |                     |                    |                   |                     |                      |
|------------------------------|-------------|----------------------|---------------------|--------------------|-------------------|---------------------|----------------------|
|                              | Stafi       | Paga/Meditje         | Mallra/Sherbime     | Shpenzime komunali | Subvencion e      | Shpenzime Kapitale  | Gjithsej             |
| Zyra e Kryetari              | 12          | 111,860.00           | 137,092.00          |                    | 46,752.00         |                     | 295,704.00           |
| Zyra e Kuvendit komunal      |             | 133,825.00           | 10,915.00           |                    |                   |                     | 144,740.00           |
| Administrata dhe Personeli   | 47          | 258,842.00           | 374,925.00          | 242,500.00         |                   | 168,000.00          | 1,044,267.00         |
| Prokurimi                    | 5           | 32,810.00            | 2,099.00            |                    |                   |                     | 34,909.00            |
| Buxhet dhe financa           | 30          | 199,058.00           | 162,713.00          |                    |                   |                     | 361,771.00           |
| Sherbime Publike             | 42          | 276,121.00           | 630,739.00          | 5,200.00           | 10,000.00         | 1,098,000.00        | 2,020,060.00         |
| Infrastruktura publike       | 7           | 46,280.00            | 16,576.00           | -                  |                   | 5,611,792.00        | 5,674,648.00         |
| Zyra Komunale per Komunitete | 13          | 68,602.00            | 8,396.00            | 500.00             |                   |                     | 77,498.00            |
| Bujqësi, Pyltari dhe ZHR     | 22          | 113,624.00           | 64,098.00           |                    | 268,000.00        | 250,000.00          | 695,722.00           |
| Zhvillim Ekonomik            | 8           | 45,483.00            | 13,926.00           |                    |                   | 332,000.00          | 391,409.00           |
| Kadastra dhe Gjeodezia       | 21          | 119,717.00           | 36,491.00           |                    |                   | 454,000.00          | 610,208.00           |
| Planifikimi Urban dhe Mjedis | 10          | 64,957.00            | 9,928.00            |                    |                   | 127,027.00          | 201,912.00           |
| <b>Shëndetësi dhe MS</b>     | <b>317</b>  | <b>2,304,783.00</b>  | <b>759,889.00</b>   | <b>64,500.00</b>   | <b>55,000.00</b>  | <b>287,000.00</b>   | <b>3,471,172.00</b>  |
| Sherbimet Sociale            | 16          | 93,834.00            | 20,347.00           | 4,700.00           |                   |                     | 118,881.00           |
| Sherbimet Rezidenciale       | 10          | 63,186.00            | 61,703.00           | 10,000.00          |                   | 32,305.00           | 167,194.00           |
| Kulturë, Rini dhe Sport      | 45          | 243,008.00           | 146,439.00          |                    | 170,000.00        | 377,000.00          | 936,447.00           |
| <b>Arsim dhe shkencë</b>     | <b>1782</b> | <b>11,046,026.00</b> | <b>999,645.00</b>   | <b>125,280.00</b>  | <b>50,000.00</b>  | <b>782,388.00</b>   | <b>13,003,339.00</b> |
| <b>GJITHSEJ</b>              | <b>2387</b> | <b>15,222,016.00</b> | <b>3,455,921.00</b> | <b>452,680.00</b>  | <b>599,752.00</b> | <b>9,519,512.00</b> | <b>29,249,881.00</b> |

Shpenzimet Komunale 2019, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe

| Programet                    | Viti 2019   |                      |                     |                    |                   |                      |                      |
|------------------------------|-------------|----------------------|---------------------|--------------------|-------------------|----------------------|----------------------|
|                              | Stafi       | Paga/Meditje         | Mallra/Sherbime     | Shpenzime komunali | Subvencione       | Shpenzime Kapitale   | Gjithsej             |
| Zyra e Kryetari              | 12          | 113,675.57           | 163,617.58          | -                  | 47,215.04         | -                    | 324,508.19           |
| Zyra e Kuvendit komunal      |             | 135,997.08           | 13,026.92           | -                  | -                 | -                    | 149,023.99           |
| Administrata dhe Personeli   | 47          | 263,043.19           | 447,468.27          | 242,500.00         | -                 | 177,238.62           | 1,130,250.08         |
| Prokurimi                    | 5           | 33,342.53            | 2,505.13            | -                  | -                 | -                    | 35,847.66            |
| Buxhet dhe financa           | 30          | 202,288.85           | 194,195.92          | -                  | -                 | -                    | 396,484.77           |
| Sherbime Publike             | 42          | 280,602.64           | 752,779.06          | 5,200.00           | 10,099.04         | 1,158,381.01         | 2,207,061.75         |
| Infrastruktura publike       | 7           | 47,031.16            | 19,783.25           | -                  | -                 | 5,932,329.20         | 5999143.6            |
| Zyra Komunale per Komunitete | 13          | 69,715.46            | 10,020.52           | 500.00             | -                 | -                    | 80,235.98            |
| Bujqësi, Pylltari dhe ZHR    | 22          | 115,468.20           | 76,500.16           | -                  | 270,654.33        | 263,747.95           | 726,370.63           |
| Zhvillim Ekonomik            | 8           | 46,221.22            | 16,620.51           | -                  | -                 | 350,257.28           | 413,099.01           |
| Kadastra dhe Gjeodezia       | 21          | 121,660.09           | 43,551.55           | -                  | -                 | 478,966.28           | 644,177.93           |
| Planifikimi Urban dhe Mjedis | 10          | 66,011.30            | 11,848.94           | -                  | -                 | 134,012.45           | 211,872.69           |
